

Bashkia: HAS

Kryetar: ADEM LALA

Fusha: INFRASTRUKTURË DHE SHËRBIME PUBLIKE

Premtime:

1. Do të zhvillohet ansambli kulturor i qytetit
2. Do të kryhet infrastruktura rrugore në lagje në territorin e bashkisë
3. Do të ristrukturohen, rrugët e fshatrave që kanë banorë më shumë, pasi edhe investimi do të jetë në raport me numrin e banorëve që përfitojnë
4. Do të hartohet një Plan Urbanistik për Bashkinë
5. Do të ndërhyet në rrjetin e ujës-jellës për të zgjidhur problemin e ujit të pijshëm 10 deri në 15 orë në ditë në qytet
6. Do të kryhet ndërtimi i qendrave të reja shëndetësore dhe rehabilitimi i atyre që sot janë të mbyllura në territorin e bashkisë
7. Do të ndertohet rruga e Bjeshkës
8. Do të restaurohen pallatet e qytetit, suvatim dhe çati të reja
9. Do të lirohet Pallati i Kulturës nga stafi i bashkisë, në këto ambiente do të synohet rikonstruksioni i sallës së lojërave
10. Do të ndërtohet një ambient për administratën e bashkisë Krumë, pasi ka rreth 25 vite që administrata e Bashkisë Krumë nuk e ka ngrehinën e saj
11. Do të rikonstruktohet rruga e Bjeshkës që të çon në Cahan
12. Do të ristrukturohet rruga e fshatit Zahrisht
13. Do të përfundojë infrastruktura rrugore e qytetit
14. Do të kryhet rruga që të çon në Cahan
15. Do të kryhet rehabilitimi i lulishteve të qytetit të Krumës
16. Do të kryhet Rruga e fshatit Zahrisht që është me financim të Fondit të Zhvillimit Shqiptar
17. Do të rikonstruktohet rruga e fshatit Nikoliq
18. Do të ristrukturohet rruga e Vlahnës
19. Do të rikonstruktohet rruga e fshatit Dobrunë që lidhet me Kosovën
20. Do të kryhet rruga e fshatit Dobrunë që lidhet me Kosovën
21. Do të kryhet rruga e Nikoliqit
22. Do të kryhet rruga e Vlahnës, e cila ka qenë në mes të investimit

Fusha: ARSIM/KULTURË/SPORT

Premtime:

1. Do të krijohet një fushë sporti në territorin e bashkisë
2. Do të rikonstruktohen dy shkolla në territorin e bashkisë

3. Do të mundësohet mbështetje në transport të nxënësve, për zonat që ka infrastrukturë, për të shmangur klasat kolektive dhe për tu arsimuar në klasa sipas moshave
4. Do të kryhet ndërtimi i shkollave të reja dhe rehabilitimi i këtyre shkollave që sot janë në gjendje të mjerueshme në territorin e bashkisë
5. Do të ndërhyet tek ndërtesa e Muzeut, i vendosur në ndërtesën e Internatit

Fusha: MJEDIS/TURIZËM

Premtime:

1. Do të merret një makinë për pastrimin e qytetit
2. Do të mbillen fidanë të rinjë pasi duke zhvilluar pyjet dhe duke jua dhënë banorëve në administrim, këtyre të fundit u vilet një taksë që do të shërbejë për të mirëmbajtur pyjet, vendosjen e rojeve, mbrojtjen nga zjarri etj
3. Do të vihet në zbatim projekti i energjisë së erës
4. Do të kryhet ngritja e një strukture për pastrimin e qytetit, duke bërë të mundur që në çdo vend të ketë kosha për mbeturinat dhe të ketë makina për pastrimin
5. Do të kryhet riaktivizimi i parqeve eolike (Energjia e erës) në zonën e Qafës së Prushit
6. Pyjet do të futen në kadastrën e hipotekës që të hipotekohen si pasuri

Fusha: BUJQËSI

Premtime:

1. Do të ndërhyet në sistemin e vaditjes nëpërmjet menaxhimit në dimër të rezervuarëve, ruajtja e digave nga shpërthimet dhe në verë pastrimi i kanaleve vaditëse
2. Do të kryhen subvencionet për fermerët
3. Do të zbatohet një program kredie me kosto të ulët për fermerët për të blerë mjete bujqësore
4. Do të kryhet ngritja e linjave të përpunimit të qumështit në territorin e bashkisë
5. Do të kryhet marketingu i zonës në mënyrë që prodhimet e bulmetit bio të kësaj zone të mund të shiten edhe në tregjet evropiane

Fusha: TRANSPARENCA

Premtime:

Fusha: SHËRBIMET SOCIALE

Premtime:

1. Do të kërkohet të kryhen punë komunitare për të marrë ndihmën ekonomike

Fusha: EKONOMI DHE PUNËSIM

Premtime:

1. Në vitin e parë dhe të dytë të mandatit do të zhvillohen të gjitha ato resurse që ka zona si bujqësia, blegtoaria, pemëtaria, minierat dhe disa ndërmarrje siç është fabrika e pasurimit kromit, deri edhe në një fabrike shkrirjeje, administrimi i ujërave të cilat janë burime që duhen aktivizuar në mënyrë që të sjellin punësim dhe rritjen e mirëqenies në zonë
2. Do të krijojnë vende të reja pune investimet në infrastrukturë
3. Do të mbështeten bizneset e vogël
4. Do të kryhet sistemimi i dokumentacionit të tokave në zonë dhe njohja e pasurisë që ka çdo familjar, pasi duke pasur një pronë çdo banor, atëherë edhe mund të investojnë në atë tokë
5. Do të rishikohen kontratat koncesionare në drejtim të zbatimit të ligjshmërisë